

**Senati Akademik**

**Datë:** 4 Shkurt 2019

**Ref.** KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS nr 5 prot

**VENDIM**

***“Për kriteret e pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve, për ndjekjen e programeve të studimit me karakter profesional në Kolegjin Profesional të Tiranës për vitin akademik 2020-2021”.***

Senati Akademik i Kolegjit Profesional të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 4 Shkurt 2019, në zbatim të kërkesave të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe Shkresës së MASR, Nr. 329 prot, datë 15.01.2019, “ Për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2020-2021”,

*vendos:*

Të miratojë dhe të përcaktojë si kriterë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, për ndjekjen e programeve të studimit me kohë të plotë, në Kolegjin Profesional të Tiranës për vitin akademik 2020-2021, si më poshtë:


1. Në programet e studimit pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kriterë:
  - a. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e Maturës Shtetërore, si edhe zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose diplomës përkatëse, që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjisllacionit në fuqi;
  - b. Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës së Studentit;
  - c. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës së Studentit;
  - d. Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të KPT.
2. Pranimi i studentëve mund ti nënshtrohet një procedure përzgjedhëse, duke u bazuar në formularin e aplikimit dhe dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti.

3. Numri i studentëve të pranuar bazohet në mundësitë reale të çdo Departamenti për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".
4. Përcaktimi i kriterëve të pranimit, si dhe procedura e aplikimeve dhe regjistrimeve në çdo rast bëhet në përputhje me parashikimet e legjisllacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Luan KARÇANAJ



Matura Shtetërore 2020

@matura.shteterore

